



Prishtinë, 26 nëntor 2010  
Kodi i ZRRE-së: V\_321\_2010

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Nenit 15, 26 dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.2004/9), të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të bërë me datë 20.10.2010 nga ndërmarrja “Repower Trading Česká republika s.r.o.” adresa: Vodičkova 710/31, Nove Mesto, 11000 Pragë 1, Republika e Çekisë,

**në seancën e mbajtur me datë 24 nëntor 2010, nxori këtë:**

**VENDIM**

- I. **I LËSHOHET** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike ndërmarrjes “Repower Trading Česká republika s.r.o.” me numër licence ZRRE/Li\_35/10, për periudhën nga data **26 nëntor 2010** deri **26 nëntor 2012**.

**Arsyetim**

- o ZRRE me datë 20.10.2010 ka pranuar me postë të rregullt aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike nga ndërmarrja “Repower Trading Česká republika s.r.o.”
  - o Kjo zyrë ka vlerësuar aplikacionin e kompanisë Repower Trading Česká republika s.r.o, dhe duke u bazuar në kërkesat sipas Aplikacionit ka kërkuar dokumente shtesë për plotësimin e dokumentacionit gjatë aplikimit për Licencë të Tregtisë nga kompania në fjalë.
  - o Pas plotësimit të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca i lejon të licencuarit që të kryejë vetëm aktivitetin e **tregtisë** së energjisë elektrike në Kosovë.
- III. Nëse i Licencuari Repower Trading Česká republika s.r.o. dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të **furnizimit** me energji elektrike, të përcaktuara në Nenin 4 të licencës me Nr. ZRRE/Li\_35/10, ai duhet të ri-aplikojë, duke plotësuar kushtet që nevojitet për këtë aktivitet, sipas udhëzimeve të ZRRE-së.

- IV.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Blerim Koci, anëtar